



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.548/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevc, anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Agim Hamza, kryesues i vendvotimit, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, paraqitur për shkak të parregullsive në Vendvotim, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET si e palejuar** ankesa ZL.Anr.548/2017 e datës 30.10.2017 e Agim Hamza, kryesues i vendvotimit, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë,

### A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 27.10.2017 nga Agim Hamza, kryesues i vendvotimit, nga radhët e LDK, dega në Podujevë, me të cilën pretendon se në vendvotimin 1824e/04R, ku ai ka qenë kryesues ka bërë disa gabime teknike gjatë plotësimit të Formularëve të Përputhjes së Rezultateve (FRP), duke bërë bartjen e votave nga bartësi i listës së kandidatëve tek kandidati i radhës i të njëjtit subjekt politik.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesën përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërliidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ta hedh si të palejuar ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpallja së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Zl.Anr. 548/2017 me datën 31.10.2017.

**Kryesuesi i Paneli**

**Hasan Shala**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa.***